Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr : 04-353/01-64245
Data: 16.09.2026
P r i z r e n

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN, me kërkesën e **KEDS-Prishtine – Projekti "Tususi III"**, me të cilën ka kërkuar leje per: Rekonstruimin e rrjetit ajror i tensionit të ulët;ndërtimi i kanalit kabllovik me gypa për **shtrirje të kabllit 0.4kV;ndërtimin e pusetave ; rikyçja e konsumatorëve ekzistues;dislokimi i njehsorëve në maje të shtyllave të betonit dhe dislokimi i njehsorëve në ormana të montuara në tokë**,në bazë të nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1, 1.4, 1.24, si dhe nenit 5, paragrafit 1.1 e lidhur me nenit 15 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110,nenit 3 pika 1.27 dhe neni 16 te Ligjit per Planifikim Hapsinor dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 dhe të nenit 44, 46, 47, 48 dhe nenit 125,127 të L.P.P.A numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 ,neni 62,124 125,126,127 dhe 128 të Rregullores për Shërbime Publike Komunale nr.001/011-73507,të dt.04.08.2024 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I LEJOHET: **KEDS-Prishtine realizimin e projektit – "Tusus III**, me të cilën ka kërkuar leje per:

- Rekonstruimin e rrjetit ajror i Tensionit të Ulët,zëvendësimi i shtyllave të vjetra të drurit me ormana të montuara në tokë dhe zëvendësimi i përçuesit të vjetër me atë të ri me kabëll nëntokësor
- Ndërtimi i kanalit kabllovik me gypa për shtrirje të kabllit 0.4kV
- Ndërtimi i pusetave me dimensione (2.0x2.0x2.0)m,(1.6x1.6x1.8)m
- Rikyçja e konsumatorëve ekzistues
- Dislokimi i njehsorëve në maje të shtyllave të betonit dhe dislokimi i njehsorëve në ormana të montuara në tokë

II. Vendosja e rrjetit të bëhet sipas dokumentacioni teknik.-projektit.

- Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projekt e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave teknike për kësi lloj punime.

III. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspekcionin komunal në afat prej 8 ditësh.

Ky Aktvendim bazohet në shqyrtimin e provave:

- Pelqim informim nga KEDS NR. 547 të datës 25.08.2026
- Pëlqimit të Drejtorisë Shërbimeve Publike Nr. 05-353/01-106011/26 të datës 26.08.2026
- Sipas pëlqimit Hidroregjioni Jugor Nr. 5065, të datës 01.09.2026
- Sipas pëlqimit Telekomi i Kosovës Nr. 186/2026 të datës 26.08.2026.

IV. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures teknike të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh.duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës

VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme dhe cdo demtim obligimi mbetet investitorrit.

VII. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

VIII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marjes së të njejtës

P.S. Sipas projektit do të bëhet shpimi nën rrugë të asfaltuar,do të bëhet prerja e asfaltit apo betonit nëpër rrugë e trrotuare,demontimi i trotuareve prej elementeve të betonit dhe riparimi i tyre (pas përfundimit të projektit do të bëhet kthimi në gjendjen e mëparshme)

A r s y e t i m

KEDS-Prishtinë ka kërkuar leje per:realizimin e projektit **"Tusus III" dhe ate për:** Rekonstruimin e rrjetit ajror i Tensionit të Ulët,zëvendësimi i shtyllave të vjetra të drurit me ormana të montuara në tokë dhe zëvendësimi i përçuesit të vjetër me atë të ri me kabëll nëntokësor

- Ndërtimi i kanalit kabllovik me gypa për shtrirje të kabllit 0.4kV
- Ndërtimi i pusetave me dimensione (2.0x2.0x2.0)m,(1.6x1.6x1.8)m
- Rikyçja e konsumatorëve ekzistues
- Dislokimi i njehsorëve në maje të shtyllave të betonit dhe dislokimi i njehsorëve në ormana të montuara në tokë

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s'bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në proceduren paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpuntorit profesional.

KEDS-i gjatë implementimit të projektit merr përsipër dhe është përgjegjës për të gjitha problemet eventuale që mund të dalin lidhur me çështjet pronësore juridike duke bërë zgjidhje sa më të mire të mundshme.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes **KEDS-Prishtine realizimin e projektit "Tusus III"**ne ngastrat kadastrale sipas projektit të prezantuar.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor-Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:

Xhejlane Gjini, inxhi. dip. ark.

Drejtori:

Florent Ukaj ecc.dipl.